



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA E PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M
Nr. 21, datë 12.08.2024

“PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS“PËR PERDORIM RRUGE,TUBACION DHE LINJE E TENSIONIT TË LARTË NE FUNKSION TE HEC GJADËR”.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar“Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016“Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika nr 2,pika 7 pika nr 22 germa f.,i *propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës*, ku në mbledhjen e datës _____._____2024 të *Këshillit të Bashkisë* të:

V E N D O S I

- 1.Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes **10.012 km rruge,4.3 km tubacion,7.344 km linje** ngastrat nr. **3/b,4/a,12/a,13/a,14/b,15/b,16/c,18,19/a,20,22,24,33a,34,35,36,,41/a,53,56/a,72,73/a,74/a,76/a,78/a79/a,79/b,96/a,96/b,97** në ekonomine pyjore **Gjadër Mnelë** dhe ng.nr **45** në ekonomine pyjore vig sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.
- 2.Afati i dhënies me qera të jetë 2- 5 vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

4. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**KRYETARI
KRISTIAN SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
ALEKSANDRA GJONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 42 prot.

Vau Dejës, më 12.08.2024

RELACION

“ PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË
SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika el , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Sipërfaqja që kërkohet të jepet në përdorim është **10.012** km rrugë, **4.3** km tubacion, **7.344** km linje.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullor bazohen në VKM **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”

Shuma në lek/vit konsiston në:

11. Për ndërtim/përdorim rrugë për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues		
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës për sipërfaqen e marrë në përdorim lek/km/vit
1	Pyll trungishte	70 000

2	Pyll cungishte	50 000
3	Pyll shkurre	35 000
4	Kullota	35 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	30 000
6	Inproduktive	25 000

10. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gaz, tensioni elektrik etj.)

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa si pas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	240 000	220 000	175 000
2	Pyll cungishte	190 000	176 000	145 000
3	Pyll shkurre	190 000	176 000	145 000
4	Kullota	190 000	176 000	145 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	160 000	145 000	110 000
6	Inproduktive	150 000	145 000	110 000

13. Ndërtim linje të tensionit të lartë

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës km/vit
1	Pyll trungishte	60 000
2	Pyll cungishte	35 000
3	Pyll shkurre	25 000

Vlera totale qe duhet të likujdoje subjekti është **1,826,630** lekë në vit (Një milion tetëqind e njetzetgjashtë mijë e gjashtë qind e tridhjetë)

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të sipërfaqes: **10.012** km rruge, **4.3** km tubacion, **7.344** km linje.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dokumentacionin e plotë dhe hartën e ekonomise.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Grupi i Punes

Ing. Mark Suli



Miratoi

Drejtori

Vehbi Shkjau



Ing. Zeqir Ujka



R A P O R T

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE
NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI
PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS.**

**“PËR PËRDORIM RRUGE,TUBACION DHE LINJE E TENSIONIT TË LARTË NE
FUNKSION TE HEC GJADËR”.**

Bazuar në Urdhërin **nr.36**, date 16.01.2024 të kryetarit të bashkisë “Për vleresimin tekniko-ekonomike për ndërtim Hec Gjadër nga subjekti “Shoqeria”S.P.E.Gjader”sh.p.k. grupi i punës i përbërë nga z. Zeqir Ujka,Përgjegjës Sektori,Z.Mark Suli, specialist i Menaxhimit të pyjeve studjoi kërkesën e subjektit(shoqërisë) “Shoqeria”S.P.E.Gjader”sh.p.k. dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore objekt i dhënies në përdorim “për përdorim rruge,tubacion dhe linje e tensionit të lartë ne funksion te hec gjadër”.

Mbështetur në të dhënat e rregjistrit kadastral pyjor/kullosor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive, rezulton që sipërfaqja e kërkuar bën pjese në **ngastrat nr. 3/b,4/a,12/a,13/a,14/b,15/b,16/c,18,19/a,20,22,24,33a,34,35,36,,41/a,53,56/a,72,73/a, 74/a,76/a,78/a79/a,79/b,96/a,96/b,97** në ekonomine pyjore **Gjadër Mnelë** dhe ng.nr **45** në ekonomine pyjore vig sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse 1 dhe 2 Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga “Shoqeria”S.P.E.Gjader”sh.p.k., nuk ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve, në ngastrën **nr. 3/b,4/a,12/a,13/a,14/b,15/b,16/c,18,19/a,20,22,24,33a,34,35,36,,41/a,53,56/a,72,73/a,**

74/a,76/a,78/a79/a,79/b,96/a,96/b,97 në ekonomine pyjore **Gjadër Mnelë** dhe ng.nr **45** në ekonomine pyjore vig, por jepen në përdorim me një afat 2-5 vjet.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim nga fondi pyjor janë të mbështetura në ligjin nr. 57 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër dhe vendimit të Këshillit Bashkiak e shprehjes së ligjshmërisë në prefekturë, shoqëria kryen aktivitetin vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë **Vau Dejës** dhe likuidimit të tarifës perkatese.

Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

Shuma në lekë/vit konsiston në:

a/1) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km/vit tubacioni

Trungishte 3.429 **km** x 220000 lek = 754,380 lekë

Inproduktive 0.871 **km** x 145000 lek = 126,295 lekë

a/1) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km/vit---Linja elektrike

Trungishte 4.302 km x 60000 lek = 258120 lekë

Shkurre 3.042 km x 25000 lek = 76,050 lekë

a/2) Vlera e përdorimit të rrugës auto në km/vit

Trungishte 7.672 km x 70000 lek = 537 040 lekë

Cungishte 0.391 km x 50000 lek = 19 550 lekë

Inproduktive 0.655 km x 25000 lek = 16,375 lekë

Toke me bimesi pyjore 1.294 km x 30000 lek = 38,820 lekë

Vlera totale që duhet të likujdoje subjekti është 1 826 630 lekë në vit (Një milion tetëqind e njetetëgjashtë mijë e gjashtë qind e tridhjetë)

Subjekti “Shoqëria S.P.E.Gjadër”sh.p.k.duhet të lekujdoje edhe vlerën e prapambetur për periudhën 18.09 2019 e në vazhdim sipas kontratës nr 6255

prot,date 18.09.2018 si dhe vleren e prapambetur per periudhen 06.12.2022 e
ne vazhdim sipas kontrates nr 6894 prot date 06.12.2021.

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing.Mark Suli



Ing Zeqir Ujka



KONFIRMOI

KRYETARI

KRISTIAN SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

ALEKSANDRA GJONI





19. Duli

2. Duli